

## **PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - SHËRBIMIN**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “SHËRBIMIN E LEXIMIT PRIMAR TË MOMOGRAFIVE”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):** 98300000-6

Shërbime të ndryshme;

**VLERA E FONDIT LIMIT: (Vlera e Pritshme e Kontratave): 2,550,000 (dy milion e pesëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.**

Fondi limit është argumentuar sipas relacionit të hartuar nga grupi i punës për llogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe argumentimin e nevojave për procedurën e prokurimit me objekt: “SHËRBIMIN E LEXIMIT PRIMAR TË MAMOGRAFIVE PËR VITIN 2025”, me nr. 366/1 prot. datë 21.03.2025.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

**a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës sipas shtojcës 3.** Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është 2% e fondit të MK në vlerën 51 000 (Pesëdhjetë e një mijë) lekë.

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin është e parashikuar se:

*Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

*Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:*

*a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllëgoartur të kontratës;*

*b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.*

Sigurimi i ofertës funksionon si një mekanizëm që garanton Ak se ofertuesi është i angazhuar dhe i gatshëm të përmbushë obligimet e tij nëse fiton kontratën. Kjo i jep autoritetit kontraktor një siguri më të madhe që ofertuesi ka seriozitet dhe mundësi për të realizuar kontratën. Gjithashtu është mbështetje për autoritetin kontraktor, pasi është një mjet për të mbuluar ndonjë humbje financiare ose dëmtim që mund të ndodhin si pasojë e mos respektimit të procedurave nga OE.

## **b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 10.**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos referuar nenit 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

Ky kriter i siguron AK që operatori ekonomik nuk ka detyrime ndaj Institucioneve Shtetërore (taksa, tatime, FSHU, etj, si dhe çdo detyrim tjetër të parashikuar në shtojcës 9 të DST) duke e siguruar Autoritetin Kontraktor që Operatori ekonomik, do ta realizojë kontratën me sukses.

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Licence e lëshuar nga QKB për kategorinë II.6.A(4).

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur nga anëtarë i NJP që ka specialitetin përkatës në lidhje me kriteret teknike dhe është në përputhje me nenin 77, pika 1/a dhe 2 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe me nenin 41, pika 4, gërma (a) të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.”

Vendosja e kriterit të 'Licencës e lëshuar nga QKB për kategorinë II.6.A(4) - Qendër mjekësore' është e rëndësishme, pasi shërbimi i leximit të mamografive është një veprimtari mjekësore shumë delikate dhe tepër e rëndësishme, që ka ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin e njeriut. Ky kriter siguron gjithashtu që qendrat mjekësore që ofrojnë këtë shërbim të jenë të pajisura me kapacitetet teknike dhe profesionale të duhura për të kryer shërbimin e saktë të leximit të imazheve të mamografisë. Po ashtu, ky kriter kontribuon në garantimin e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve që kërkohen për realizimin e kësaj procedure.

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022, 2023 dhe 2024) të lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

**Argumentimi:** Ky kriter, eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020, "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, ne te cilin gjejme te percaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.;* ne piken 1 dhe piken 2/c te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku percaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar (...); Vendosja e ketij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Legjislatori në ne piken 1 dhe piken 2/c te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, ku percaktohet; Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar,; Referuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure AK ka menduar se vendosja e nje vlere minimale te xhiros **sa 40 % e vlerës së fondit limit\***, **eshte nje deshmi e mjaftueshme per te krijuar** bindjen tek Autoriteti Kontraktor se Operoret Ekonomike ofertues zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

*AK ka parashikuar vlerën jo më pak se 40 % në mënyrë që të nxisë pjesëmarrjen e sa më shumë OE-ve të cilat kanë eksperiencën e nevojshme dhe stabilitetin e nevojshëm për të kryer me sukses kontratën në rastin e shpalljes fitues, duke qenë se objekti i kontratës është specifik, dhe është në përputhje me natyrën, vlerën e objektit të kontratës.*

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata,*

**për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;** si dhe nenit 61 pika 2 të Ligjit nr. 29, datë 30.03.2023 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se **15 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në përputhje me pikën 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën enevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës..;* si dhe me pikën 3 të nenit 41 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: *[...]3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të*

*legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara”.*

*Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.*

**Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 3 të nenit 41 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se **15 %** të vlerës së fondit limit të të vlerës së pritshme të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

*Vendosja e ketij kriteri bëhet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.*

*AK ka parashikuar vlerën jo më të vogël se 15 % në mënyrë që të nxisë pjesëmarrjen e sa më shumë OE-ve të cilat kanë eksperiencën e nevojshme dhe stabilitetin e nevojshëm për të kryer me sukses kontratën në rastin e shpalljes fitues, duke qenë se objekti i kontratës është specifik, dhe është në përputhje me natyrën, vlerën e objektit të kontratës.*

---

**2.3.2** Deklaratë nga OE që disponon pajisjet dhe softuerët e nevojshëm për të lexuar imazhet e mamografive të prodhuara nga njësia lëvizëse **“Mamography Unit me X-Ray tube dhe Direct Conversion Amorphous Selenium detector, 24x30 cm format, jo Isocentric (HELIANTHUS)”**. OE ka të drejtë të inspektojë paraprakisht llojin e pajisjeve që kryejnë ekzaminimet dhe prodhojnë imazhet e mamografisë, pranë ambienteve të ISHP-së.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4 (b) dhe (ç), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë aftësitë teknike nëpërmjet pasijeve dhe softetve e përshatshme për të garantuar AK për zbatimin e kontratës, me objekt leximin primar të imazheve të mamografisë.

**2.3.3** OE duhet të ketë të paktën një punonjës, i cili të jetë Mjek i diplomuar nga Fakulteti i Mjekësisë, gjithashtu i specializuar në specialitetin **Diagnozë me Imazhe**, dhe i licensuar nga Urdhëri i Mjekut të Shqipërisë për këtë specialitet (Diagnozë me Imazhe).

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10. Ky dokumentacion dëshmuës do të paraqitet nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara

publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit. Autoriteti/enti kontraktor kërkon nga ofertuesi i kualifikuar të paraqesë dokumentet provuese për vetëdeklarimet, sipas shtojcës 10 të DST, të cilat duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Për mjekun e diplomuar nga Fakulteti i Mjekësisë, gjithashtu i specializuar në specialitetin **Diagnozë me Imazhe**, OE duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme:

- **Kontrata e punës, midis OE dhe mjekut të licensuar.**
- **Diplomën e Fakultetit të Mjekësisë.**
- **Diplomën e specializimit.**
- **Licencën e lëshuar nga Urdhëri i Mjekut të Shqipërisë për këtë specialitet (Diagnozë me Imazhe), e cila duhet të jetë aktive për gjatë gjithë periudhës së kontratës.**
- **CV-në e mjekut/mjekëve të licensuar në **Diagnozë me Imazhe**, ku të dëshmohet edhe përvoja e punës në lidhje me leximin e mamografive, shoqëruar me një referencë profesionale**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë stafin e kualifikuar dhe personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës. Vendosja e këtij kriteri për stafin teknik është bërë në përputhje me specifikimet teknike dhe nevojën për kryerjen e shërbimit të leximit primar të mamografive, duke siguruar Autoritetin Kontraktor (AK) se operatori ekonomik (OE) zotëron burimet njerëzore teknike të nevojshme për të zbatuar kontratën, si dhe siguron cilësinë e stafit teknik nëpërmjet licencimit të tyre.

*(Shënim: Argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar shërbimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale. Po ashtu, duhet të argumentoni kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi dhe, nëse është rasti, llojin e licencës, certifikatës ose kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre.)*

## Shtojca 6 .

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

**Ekzaminimet mamografike** kryhen nga Njësitë lëvizëse të mamografive të tipit Helianthus të kompanisë prodhuese Metaltronica S.p.A. dhe kanë specifikimet e përgjithshme si më poshtë:

*Mamography Unit me X-Ray tube dhe Direct Conversion Amorphous Selenium detector 24x30cm format me jo Isocentric (HELIANTHUS).*

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Modeli i kërkuar i përgjigjes nga ana e OE për leximin e imazheve duhet të paraqesë informacionin si më poshtë:

1. Emri dhe mbiemri i personit që ekzaminohet.
2. Rrethi sipas kodit të vendosur në Databasën e mamografisë së levizshme.
3. Moshë (data, muaji, viti)
4. ID bazuar në kartën e identitetit të personit.
5. Data e kryerjes së mamografisë në terren.
6. Data e leximit të mamografisë.
7. Konkluzionet lidhur me gjetjet radiologjike.
8. Kategorizimi sipas sistemit radiologjik BI-RADS dhe përshkrimi për ndjekje të mëtejshme.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

- Përgjigjet e leximit të mamografive duhet të jenë të nënshkruara nga mjeku që i ka lexuar dhe OE përkatës.
- Përgjigjet e leximit duhet të dorëzohen në dy kopje pranë AK, përfshirë një kopje në CD dhe një kopje në format hard copy, dhe të shoqërohen me listën analitike të emrave.

**Argumentimi: Specifikimet teknike** janë vendosur në përputhje me Ligjin nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të cilin ngjajmë të përcaktuar se: “38. “*Specifikime teknike*” janë: b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrimi i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzimi i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shihet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe

*metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë”, në VKM-në me nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenin 41, pika 1, në të cilin ngjehmë të përcaktuar se: “Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.”.*

#### **Shtojca 7.**

*(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### **FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

Shërbimet që kërkohen janë 5,000 copë imazhe të pritshme të mamografive, të cilat do të lexohen gjatë një periudhe 12-mujore, sipas kërkesave të përcaktuara nga AK.

#### **Afatet e ekzekutimit:**

Imazhet e kryera (nga njësitë lëvizëse të mamografisë), nga Autoriteti Kontraktor (AK), do t’i vihen në dispozicion Operatorit Ekonomik (OE) për t’u lexuar periodikisht. Përgjigjet e leximeve të imazheve do të dorëzohen në Institutin e Shëndetit Publik (ISHP), jo më vonë se 1 muaj nga data e dorëzimit të imazheve nga AK, nëpërmjet procesverbaleve përkatëse.

**Argumentimi: Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit** janë vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 41 të VKM-së Nr. 285, date 19.05.2021 i ndryshuar, në të cilin ngjehmë të përcaktuar se: “Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.”.



## **Shtojca 8.**

( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

### **TERMAT E REFERENCES**

#### **Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:**

Shërbimi i leximit primar të mamografive të kryera nga njësia lëvizëse me tip makine mamografike **Helianthus** të kompanisë prodhuese **Metaltronica S.p.A.** dhe ka specifikimet e përgjithshme si më poshtë:

- Njësia mamografike me **X-ray tube** dhe **Direct Conversion Amorphous Selenium detector**, format 24x30 cm, jo Isocentric (HELIANTHUS).

#### **Detyrat:**

OE do të kryejë leximin e imazheve me anë të Mjekut imazherist që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shtojcën nr. 9.

Imazhet e kryera (nga njësitë lëvizëse të mamografisë) nga AK do t'i vihen në dispozicion OE për t'u lexuar dhe përgjigjet e leximeve të imazheve do të dorëzohen në ISHP.

OE është i detyruar të ruajë fshehtësinë e informacionit, me përjashtim të AK-së, të cilit do t'i vihen në dispozicion interpretimet e leximeve të imazheve. Raporti i interpretimit të imazheve të mamografive duhet të jetë i nënshkruar nga Mjeku specialist (imazherist/diagnozë me imazhe) dhe përfaqësuesi ligjor i OE.

Përgjigjet e leximit të mamografive duhet të jenë të nënshkruara nga mjeku që i ka lexuar dhe OE përkatës.

Përgjigjet e leximit duhet të dorëzohen në dy kopje, edhe me CD, pranë AK-së, shoqëruar me listën analitike të emrave.

#### **Shpërndarja:**

Leximi i imazheve do të dorëzohet pranë ISHP-së me procesverbal përkatës.

#### **Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:**

Shërbimi do të kryhet me pajisjet e OE fituese dhe në ambientet e OE fitues, dhe do të dorëzohen në ISHP.

**Argumentimi:** Terma e references janë vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 41 të VKM-së Nr. 285, date 19.05.2021 i ndryshuar, në të cilin ngjajmë të përcaktuar se: "*Në procedurat e*

*prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.”.*